REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 664/22
Datë/Datum. 01.12.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ismail Rushiti,	*Data e autorizimit të Ekspertit*	*Data e dorëzimit të Raportit*	*Numri i lëndës*
Ekspert shqyrtues i jashtëm	*22.11.2022*	*01.12.2022*	*664/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë *16.11.2022*, **OE "DEZINFEKTIMI AD" SH.P.K**, ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), evidentuar me numër të lëndës 664/22, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) për aktivitetin e prokurimit: **"Shërbimet e pastrimit të brendshëm dhe sanitarisë"**, me numër të prokurimit: **Nr. AP: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1**, iniciuar nga **AK– SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 756 612,00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Njoftimi për Kontratë: 18.10.2022
Hapja e paraparë: 16.11.2022
Kërkesë për rishqyrtim:.....09.11.2022
VENDIMI i AK-së:.....10.11.2022

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) – LPP
Neni 7 (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) – LPP
Neni 69 (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale) – LPP
Neni 26.8 (Kriteret e përzgjedhjes) - RRUOPP

DEKLARATA DETALE E ANKESËS:

Autoriteti Kontraktues me datën 18.10.2022 ka publikuar njoftimin mbi korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, duke shtuar disa kërkesa në dosjen e tenderit, e që ne mendojmë se të njejtat nuk janë kërkesa në përputhje me dispozitat e LPP-së, dhe janë në kundërshtim me Qëllimin e kontratës sipas nenit 1 të LPP-së, dhe nenit 7 të LPP-së, pasi që të njejtat pos që janë të tepërta janë edhe diskriminuese dhe i jep kuptim se si Autoritet Kontraktues favorizoni ndonjë operator të caktuar ekonomik.

Autoriteti Kontraktues është dashur që të ketë në konsideratë Nenin 6 paragrafin1 të LPP-së pasi që në parim ceket mjaftë kjartë se "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën sa më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".

Autoriteti Kontraktues poashtu nuk ka pasur parasysh as dispozitat tjera ligjore si Nenin 7 paragrafin 1 ku thuhet "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente" dhe paragrafin 2 ku ceket "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".

Kërkesat e Autoritetit Kontraktues tek pozicioni 9.1 & 9.2 (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale), Autoriteti kontraktues është dashur që të veproj konform Nenit 7 të LPP-së dhe Nenit 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ (RrUOPP) që gjatë hartimit të kërkesave të vendos kërkesa normale dhe jo favorizuese.

Kërkesat e AK-së sa janë diskriminuese për OE më tepër janë favorizuese për OE të caktuarë kriteret e tilla shpërfaqin monopol në tregë dhe krojojnë pasiguri për pjesëmarrje sa më të gjerë të OE-ve të interesuar.

Si shembull

4. Kërkesa OE të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 – Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e Higjienës

Kërkesa 5. OE të jetë i certifikuar me ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit për shërbimet e Higjienës

Kërkesa 6. OE të jetë i certifikuar me ISO 45001 – 2018 – Sistemi i menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e pastrimit

pastrimit por vetëm ngarkesë shpenzuese për OE pasi që jemi mirë të vetë dijëshem se këto standarte të kërkuara problem të jemi të njohur edhe si shtetë.

Kërkes tjetër e panevojëshme dhe diskriminuese
Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 100,000 euro asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 100,000.00euro qasje për kredi në dispozicion.
Kjo këresë përveq se është diskriminues e panevojshme ka edhe tendenca që AK në këtë rast të tentoj të ushtroj ndikimin e tij tek OE edhe në menagjim financiar të bugjetit të OE-së pasi që është shumë e pakuptimit OE të detyrohet të marr një kredi apo të bëjë kërkes që në të ardhmen të ketë kredi. Kjo këkres bie në kundërshtim e edhe me kërkesen e egzekutimit të ofertës që në këtë rast juve e keni kërkuar 10%, Polica e egzekutimit është garancë për secilin dështim të OE-së dhe nuk e kuptojm pse duhet të ketë edhe një të tillë.

Kërkesa tjetër

Kërkesa 2. Oe duhet të ketë 5 puntorë të çertifikuar per mbrojtjen fillestare nga zjarri

Me këtë kërkes si duket keni këruar që punëtori i pastrimit të kryej edhe shume detyra tjera që bie ne kundërshtim me rregullat e punës të përcaktuara nga SHSKUK kjo për arsye se juve jeni mirë në dijeni se për mbrojteje nga zjarri egziston ekip e veqantë që është në gjendje gadishmërie për veprim 24/7 në kuadër të spitalit, madje janë edhe punëtorët e sigurimit që ofrojnë një shërbim të tillë.

Tjetër kërkes

Listën e pajisjeve për realizim te punëve,kësaj liste duhet ti bashkangjiten dëshmi mbi pronësin apo marveshjen me qira të mjeteve.Listës duhet ti bashkëngjiten ,njëra nga këto dëshmi ,DUD doganorë apo faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen – kopje.Lista e paisjeve duhet te jetë e notorizuar nga noteri me procedura aktnoterial

Neve e kuptojm që pasijet e kërkuar janë të domosdoshmë për pastrim dhe janë kejt esencaile që edhe po të dojë nje OE të zhvilloj punën pa to do jetë e pamundur por kërkesa juaj që të jenë me aktë noterial është e tepërt pasi që si do që të kërohet pasijet janë themelore për punë dhe kërkesa do ishte e mjaftueshme që të ofrohet lista me dëshmi pronësie ose marrëveshja për marrje me qera (kopje).

Lidhur me pagën kërkojm që kërkesa juaj ku keni thënë

Evidenca 9. Analiza financiare për pagën bazë 302 € bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ATK-së.

Kërojm që ttë mirëqartësohen pasi që jeni në dijeni se Ligji i Punës dhe ATK ka poltë mundësi që të ketë pagesa shtesë për punëtor ndaj kërkojm që të qartësoni se cilat nga to duhet të kalkulohen.

Lidhur me material ju keni cekur
Materiali duhet te jene me cilesi te larte dhe ekologjik si dhe cmimi i materialit duhet te jete I bazuar ne cmimin e tregut aktual. Çmimi jo normalisht i ulet i materialit e ben oferten e pa pergjegjshme, duke u bazuar ne Ligjin e Prokurimit Publik.

Ju lutem na e cekni qartë se me qka do të bëhet matja(pranimi i qmimit) e qmimit të tregut duke e ditur se viteve të fundit ka vetëm rritje dhe qmimet që ne ofrojm në qka do i bazoni se janë të tregut.

Në faqen nr.60 të RrUOPP-së i keni kriteret e matshme që mund ti përdorni sipastabelarit (Në rast të kontratave për ofrimin e shërbimeve) pika a, dhe pika d), ku lidhurme stafin menaxherial (kualifikimet e tyre) dhe lidhur me minimumin e mesatares së

fuqisë punëtore, të cilat ndërlidhen me Nenin 69 të LPP-së.

Kërkojmë nga ana e AK-së që të APROVOJ kërkesën tonë për rishqyrtim dhe të korrigjoj dosjen e tenderit dhe të largon kërkesat e panevojshme nga ky aktivitet i prokurimit të cilat konsiderojmë se janë të tepërta, të panevojshme dhe diskriminuese marr parasysh natyrën dhe qëllimin e kësaj kontrate.

Pas kësaj krkese tonë AK në vendimin e datës 10.11.2022 ka bërë REFUZIMIN e këkeses tonë duke u thirrur se "kinse" disa AK ka vendosur kritere të njejta por nuk ka kthyer përgjigjëje profesionale, andaj kërkojm nga PSH që të APROVOJ ankesen tonë dhe AP ta këthej ne ri-shyrtim-rivendosje të kritereve.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:		*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).		Evidenca 1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit Spitali Pergjithshem Gjilan ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të SHKUK, për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe Spitali Pergjithshem Gjilan do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë. Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (origjinali ose kopja e noterizuar) Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]. (kopje).
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale:**
		Kërkesa 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit , regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.
		Kërkesa 2. Certifikatë e numrit

		Dëshmia e kërkuar dokumentare:
		Evidenca 1. Te dëshmohet me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-Kopje
		Evidenca 2. Te dëshmohet me Certifikatë te Numrit Fiskal-Kopje
		Evidenca 3. Te dëshmohet me Certifikatë te

		fiskal. Kërkesa 3. Certifikatë e TVSh-së. 4. Kërkesa OE të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 – Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e Higjienës Kërkesa 5. OE të jetë i certifikuar me ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit për shërbimet e Higjienës Kërkesa 6. OE të jetë i certifikuar me ISO 45001 – 2018 – Sistemi i menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e pastrimit	TVSh-së Kopje. Evidenca 4. OE duhet të dëshmoj kopje të certifikatës ISO 9001-2015 të akredituar në Menaxhim të Cilësisë për shërbimet e Higjienës (Me validitet) Evidenca 5. OE duhet të dëshmoj kopje të certifikatës ISO 14001-2015 më akreditim në Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit për shërbimet e Higjienës (Me validitet) Evidenca 6. OE duhet të dëshmoj kopje të certifikatës ISO 45001 2018, më akreditim në Sistemi i menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e Higjienës (Me validitet)
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 1,134,918€, për tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.** **Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 100,000 euro asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 100,000.00euro qasje për kredi në dispozicion.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1. Të vërtetohet me deklaratat e të ardhurave nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), apo me pasqyrat e audituara nga një autoritet i akredituar në Kosovë. Për kompanitë e huaja, Kompania duhet të jetë e regjistruar si kompani (degë) në Republikën e Kosovës, të dhënat financiare kompania mund ti përdor nga kompania amë (bazë).** **Evidenca 2. Deklarata nga banka që vërteton disponushmërinë e 100,000.00 euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar origjinal (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të merr kredi prej 100,000.00 eurove nëse është e nevojshme.** **Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit ne fjale.**

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 1. Listen e kontratave te realizuar per tri vitet e fundit te bashkangjitura kontratat, çertifikate ose raporte te pranimit për shërbime në lëmin e pastrimit të natyrës së njejtë ne tri vitet e fundit, nga data e njoftimit për kontratë jo me pak se 1,000,000 €.** **Kërkesa 2. Oe duhet të ketë 5 puntorë të çertifikuar per mbrojtjen fillestare nga zjarri** **Kërkesa 3. OE duhet të ofroj një deklarta me shkrim për realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike.** **Kërkesa 4. OE të jetë i pajisur me dokumentacion sipas kërkesave të ligjit 04 L-161 Për siguri dhe shëndet në punë.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Evidenca 1. OE duhet të ofroj dëshmi me listen e kontratave te realizuar me tri vitet e fundit te bashkangjitura kontrata, certifikate ose me raporte te pranimit se ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit te natyrës së njejtë ne tri vitet e fundit, nga data e njoftimit për kontratë jo me pak se 1,000,000 €.** **Evidenca 2. Oe duhet të ketë 5 puntorë të çertifikuar per mbrojtjen fillestare nga zjarri si dhe te kete deshmi me kontrate pune ose te angazhuar per kete aktivitet me kontrata. Kontrata duhet te jene te nenshkuar nga dy palet dhe volusura kopjet e kontratave duhet te jeni te noterizuar.** **Evidenca 3. OE duhet të ofroj një deklarta me shkrim për realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike.** **Evidenca 4. OE të jetë i pajisur me dokumentacion sipas kërkesave të ligjit 04 L-161 Për siguri dhe shëndet në punë.**
		Kërkesa 5. OE duhet të ketë staf profesional si dhe të ketë përvojë në shërbimet si dhe përgatitje adekuate shkollore. 1. Së paku një (1) Menaxher **Kërkesa 6. Operatori Ekonomik duhet të paraqes në formë organogrami listën e materialeve higjienike sipas spsecifikave teknike të paraparë në këtë tender. Kërkesa 7. Deklaratë me shkrim e nënshkruar nga Ofertuesi për pagën bazë për punëtorët në këtë projekt të jetë 302 € bruto.** **Kerkesa 8 Lista e paisjeve a)1 (një) Automjet me kran (shporte) për punë (Vinç). b)1 (një) Pikap c) 1 (një) Makinë për larjen e pllakave. d)1(një) Makinë për thithjen e ujit. e)2 (dy) makine per larjen dhe terjen e dyshemeve.(meakumulator ose me rryme) f)15 (pesembedhjete)**	**Evidenca 5. OE duhet të ketë staf profesional si dhe të ketë përvojë në shërbimet si dhe përgatitje adekuate shkollore. 1. Së paku një (1) Menaxher** **Evidenca 6. Operatori Ekonomik duhet të paraqes në formë organogrami listën e materialeve higjienike sipas spsecifikave teknike të paraparë në këtë tender. Evidenca 7. Deklaratë me shkrim e nënshkruar nga Ofertuesi për pagën bazë për punëtorët në këtë projekt të jetë 302 € bruto.** **Evidenca 8 Lista e paisjeve a)1 (një) Automjet me kran (shporte) për punë (Vinç). b)1 (një) Pikap c) 1 (një) Makinë për larjen e pllakave. d)1(një) Makinë për thithjen e ujit. e)2 (dy) makine per larjen dhe terjen e dyshemeve.(meakumulator ose me rryme) f)15 (pesembedhjete) Kova per pastrim. g)5(pese) Fshesa me korrent. h) (nje) Makine per larjen e tepihave dhe thithjen e ujit** **Listën e pajisjeve për realizim te punëve,kësaj liste duhet ti bashkangjiten dëshmi mbi pronësin apo marveshjen me qira të mjeteve.Listës duhet ti bashkëngjiten ,njëra nga këto dëshmi ,DUD doganorë apo faturë për blerjen ose kontrata mbi**

		Kova per pastrim. g)5(pese) Fshesa me korrent. h) (nje) Makine per larjen e tepihave dhe thithjen e ujit Kërkesa 9. Analiza financiare për pagën bazë 302 € bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ATK-së. Kërkesa 10. Planin e Menaxhimit për këtë aktivitet të prokurimit	qiramarrjen – kopje.Lista e paisjeve duhet te jetë e notorizuar nga noteri me procedura aktnoterial Evidenca 9. Analiza financiare për pagën bazë 302 € bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ATK-së. Evidenca 10. Operatori ekonomik duhet te deshmon me Planin e Menaxhimit për këtë aktivitet të prokurimit

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

NJË PËRSHKRIM LIDHUR ME KËTË AKTIVITET TË PROKURIMIT

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues **SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN**, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: **"Shërbimet e pastrimit të brendshëm dhe sanitarisë"**, me numër të prokurimit: **AP: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1**, procedurë e hapur, lloji i kontratës: Shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: **756 612,00 €.**

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 18.10.2022, ndërsa me datë 21.10.2022 ka publikuar Formulari standard (B54) për korrigjimin e njoftimit e publikuar.

Me datë 09.11.2022 **OE "DEZINFEKTIMI AD" SH.P.K**, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, lidhur me Dosjen e Tenderit dhe me Njoftimin për Kontratë.

Ndërsa, AK me datë 10.11.2022 ka nxjerrë Vendim për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, duke vërtetuar Vendimin e AK-së lidhur me Njoftimin për Kontratë për këtë procedurë të prokurimit. Rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 16.11.2022 **OE "DEZINFEKTIMI AD" SH.P.K** , ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 664/22, dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Eksperti shqyrtues i prokurimit, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore, andaj duke u bazuar në kërkesat e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, (Kërkesat dhe Dëshmitë), konsideroj se, **pretendimi i OE ankues qëndron**. Për faktin se, Autoriteti Kontraktues gjatë përgatitjes të këtij aktiviteti të prokurimit, ka përcaktuar kritere të larta dhe nuk ka sqaruar mjaftueshëm KËRKESAT dhe DËSHMITË e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, sepse ky përshkrim në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit krijon paqartësi dhe konfuzitet, rrjedhimisht kufizon konkurrencën e Operatorëve Ekonomik për këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues konsideron se, në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, disa nga kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues, si më poshtë janë kërkesa të larta dhe kufizuese:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

4. Kërkesa OE të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 – Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e Higjienës

Kërkesa 5. OE të jetë i certifikuar me ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit për shërbimet e Higjienës

Kërkesa 6. OE të jetë i certifikuar me ISO 45001 – 2018 – Sistemi i menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e pastrimit

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare:

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 1,134,918€, për tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 100,000 euro asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 100,000.00euro qasje për kredi në dispozicion.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa 1. Listen e kontratave te realizuar per tri vitet e fundit te bashkangjitura kontratat, çertifikate ose raporte te pranimit për shërbime në lëmin e pastrimit të natyrës së njejtë ne tri vitet e fundit, nga data e njoftimit për kontratë jo me pak se 1,000,000 €.

Kërkesa 2. Oe duhet të ketë 5 puntorë të çertifikuar per mbrojtjen fillestare nga zjarri

Kërkesa 4. OE të jetë i pajisur me dokumentacion sipas kërkesave të ligjit 04 L-161 Për siguri dhe shëndet në punë.

Kërkesa 5. OE duhet të ketë staf profesional si dhe të ketë përvojë në shërbimet si dhe përgatitje adekuate shkollore. 1. Së paku një (1) Menaxher

Kërkesa 7. Deklaratë me shkrim e nënshkruar nga Ofertuesi për pagën bazë për punëtorët në këtë projekt të jetë 302 € bruto.

Gjithashtu, në Dosjen e Tenderit AK ka kërkuar si në vijim, citojmë:

"OE-ik duhet te deklaroje se do ti punesoj 54 punetore si dhe 1(nje) menaxher dhe 1(nje) pergjegjesa per kryerjen e ketyre sherbimeve . Nr punetorve eshte sasia indikative

- *Paga Bruto per 1(nje) punetore eshte 302.00€, plus 5% kontributet e punedhenesit, paga(Bruto) per menaxherin 380.00€ plus 5% kontributet e punedheneit, menaxhrei duhet te kete te perfunduar fakultetin Ekonomik ose Juridik ose Masterin dhe te kete 4 vite pervoje pune, edhe paga (Bruto) per pergjegjes te jete 350.00€ duke perfshire plus 5% te kontributit te punedhenesit. Se paku te kene te perfunduar shkollen e mesme dhe te kene pervoje pune 2 vite".*

Eksperti Shqyrtues konstaton se, këto kërkesa të vendosura nga Autoriteti Kontraktues janë larta dhe disa të pa arsyeshme, kështu që përveçse kufizojnë pjesëmarrjen e Operatoreve Ekonomikë, po ashtu e kufizon dhe ndikon direkt te punëtorët brenda kompanisë.
Kriteret, kushtet, kërkesat dëshmitë dhe specifikimet në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë duket ti specifikojnë në mënyrë të qartë jo diskriminuese dhe të kuptueshme për Operatorët Ekonomik.

Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 7 të LPP-së **"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".**

Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë **drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale** për objektin e kontratës në fjalë.

Sipas neni 26.4 të URROPP, Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Të arsyeshme dhe të mjaftueshme".

Ndërsa,

Neni 18.4 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, përcakton:

"18.4 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratës në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. **Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre.** Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve. Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. Ne rast se AK organizon vizite ne vend-punishte apo konference para-ofertuese, pjesëmarrja e OE ne vizite ne vend-punishte/konference paraofertuese nuk duhet të jete obligative. Vizita ne vend-punishte/konference para-ofertuese organizohet për OE dhe është ne të mirën e tyre, pra është ndihmese për OE".

Andaj, Eksperti Shqyrtues i prokurimit, duke u bazuar në të gjeturat e lartpërmendura, i propozon AK-së "SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN", që të ulen kriteret në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, dhe gjithashtu duke i sqaruar mjaftueshëm në mënyrë që mos të redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik. Pra, AK në fjalë t'i bëjë përmirësimet e nevojshme në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, nëpërmjet korrigjimit të procedurës përkatësisht Formularit (B54) për procedurën përkatëse dhe të veproj në pajtim me nenin 53.7 të LPP-së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, rrjedhimisht i propozon Panelit Shqyrtues të OSHP-së, të obligohet Autoriteti Kontraktues t'i bëjë **korrigjimet e nevojshme në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe të veproj në pajtim me nenin 53.7 të LPP-së.**

RAPORTI I EKSPERTIZËS TI DORËZOHET:

- Autoritetit Kontraktues – SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – OE "DEZINFEKTIMI AD" SH.P.K